

VENDIM
Nr. 78, datë 6.4.2018

MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË KA NËNSHKRUAR OSHEE SHA ME SHOQËRINË E LICENCUAR NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” SHPK (AES SHPK)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të nenit 20, pika 1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sh.a, me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “*Albanian Energy Supplier*” sh.p.k. (AES sh.p.k.),

konstatoi se:

- Shoqëria “OSHEE” sh.a., me shkresën nr. 4121 prot., datë 5.3.2018, ka dërguar në ERE marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nr. 1714 prot., datë 29.1.2018 dhe nr. 007 prot., datë 30.1.2018, nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe “*Albanian Energy Supplier*” sh.p.k., me qëllim miratimin nga ERE në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 24, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, ka vendosur për licencimin e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 38, datë 18.3.2015, ka licencuar shoqërinë “*Albanian Energy Supplier*” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike (AES sh.p.k.), për një afat 5-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 15.2.2017, ka miratuar “Marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”.

- Në nenin 20, pika 1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”, sanksionohet se: “Kjo marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE”.

- Në përmbajtjen e saj, kjo marrëveshje e nënshkruar dhe e dakordësuar mes palëve ka reflektuar saktësisht të gjitha dispozitat që ERE ka parashikuar në marrëveshjen tip të cilën e ka miratuar me vendimin e bordit nr. 24, datë 15.2.2017.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nr. 1714 prot., datë 29.1.2018 dhe nr. 007 prot., datë 30.1.2018, nënshkruar midis shoqërisë OSHEE sh.a. dhe shoqërisë “*Albanian Energy Supplier*” sh.p.k. (AES sh.p.k.).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti